



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS – SHTIME
Komiteti për Komunitete
Nr.01-060/01-14464/25 datë:23.06.2025



Npi – 01/226 datë: 26.06.2025

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, Si dhe në bazë të nenit 3.8 dhe 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/114 datë: 26.04.2019. Komiteti për Komunitete për mbledhjen e mbajtur më: 26.06.2025, nxjerr këtë:

E K S T R A K T
P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË -VI- TË KOMITETIT PËR KOMUNITETE

E mbajtur më: 26.06.2025 (e enjte) në ora 15:00 h. në sallën e vogël të Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesi, z.Bajram Ilazi, anëtarët e Komitetit për Komunitete: z.Besnik Seferi, z.Artan Lubovci, znj.Rrezartë Ramadani, dhe z.Arton Demiri, znj.Arjeta Maliqi, znj.Sabrie Velu. Përveç anëtarëve të Komitetit në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF-së, Zyrtari për Komunitete dhe Kthim z.Muhamet Mehmeti, z.Florent Salihu nga UNMIK-u, si dhe znj.Vlora Hyseni, zyrtare për informim. Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Komitetit z.Bajram Ilazi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, Konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm prej 7 anëtarëve prezent, për të vazhduar me mbledhjen Komitetit. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e KPK-se më 27.05.2025,
2. Draft-Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2026-2028, (Pas diskutimit publik)
3. Informatë nga ZKKK-ja për mbështetjen e komuniteteve në muajin Qershor 2025,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi: Hapi diskutimin për rendin e ditës.

***Komiteti për Komunitete, unanimitisht miratoi rendin e ditës.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e KPK-se më 27.05.2025

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi: Hapi diskutimin për këtë pikë.

***Komiteti për Komunitete, unanimitisht miratoi Ekstrakt Procesverbalin nga mbledhja më 27.05.2025.**

Pika 2

Draft-Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2026-2028, (Pas diskutimit publik)

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi: Drejtorin nuk e kemi prezent, sigurisht ka ndonjë arsye sepse ai gjithmon ka qen prezent, sidoqoftë unë po e hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Besnik Seferi: Përshëndetje. Fillimisht unë i uroj mirëseardhje 2 anëtareve të reja të KPK-së znj.Arjeta Maliqit dhe znj.Sabrie Velu. Sa i përket KAB-it unë kamë marrë pjesë në diskutime

publike, por për fat të keq nuk kemi pas përfaqësimit në këto takime nga ana e përfaqësuesve të komuniteteve, përveq me Arjeta Maliqi. Kërkesa për rritje të buxhetit për Zyren për komunitete duhet të del nga këtu si propozim. Unë kam marrë pjesë në diskutimet që janë bërë në Gjyrkoc. E mira është se buxheti po bëhet në të mirën e të gjithë banorëve pa dallim. Në këto diskutime ka pas kërkesa për rregullimin e trotuareve, kanalizimeve, ndriçimeve etj.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi: Një prej meritave të komitetit ka qenë edhe rritja e buxhetit nga 6 mijë euro sa ka qenë, tani i kemi 10 mijë euro.

Në Gjyrkoc nuk kemi mujt me ardhë në diskutim publik, mirëpo këtu banorët nuk ndjehen të segreguar ose të ndarë, por jetojmë të gjithë bashkarishtë, edhe projektet janë të përbashkëta.

znj.Rrezartë Ramadani: Edhe unë po e shprehim gatishmërinë që këtë qështje t'a ngrisë në Kuvend që e kemi njerë, e që ka të bëjë me ngritjen e buxhetit për zyren për komunitete.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Përshëndetje. Ky KAB, pas diskutimit publik ka rezultuar me disa ndryshime. Në vazhdim drejtori i saktësoi me shifra të gjitha kodet buxhetore. Buxheti për vitin 2026 është planifikuar që të jetë rreth 11 milionë. Ky buxhet do të shpërndahet nëpër kategori ekonomike proporcionalishtë. Te mjekësia janë të parapara 4 vende të lira të punës, po bëhet fjalë te mjekësia primare, po ashtu 6 vende pune të çerdhja e fëmijëve në fshatin Petrovë. Materialin për këtë mbledhje e kemi marrë me kohë, nëse ka ndonjë pyetje do të përgjigjem.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi: Unë i kamë disa propozime që kisha dashtë me i bërë rekomandime për Kuvend. E para të rritet buxheti në ZKKK-ë edhe për 2 mijë euro, edhe pse buxheti për këtë zyre është rritur për 100% ku është një sukses i komunës. Rritjen po e kërkojmë duke marrë parasyshë nevojat e mëdha të komunitetit pakicë. E dyta propozojmë që në ZKKK-ë të pranohet edhe një zyrtarë. E treta propozojmë që të caktohet një vijë buxhetore rreth 2 mijë euro të DKRS-ja për organizimin e manifestimit dinjitozë për ditët e rëndësishme të komunitetit romë dhe ashkali. E katërta propozojmë që të ndërmerren hapa për funksionalizimin e qendrave për mësim në fshatrat Gjyrkoc dhe Vojnovc.

znj.Arjeta Maliqi: Përshëndetje. E përkrahu edhe unë propozimin e kryesuesit për ndarjen e një vije të veçantë të buxhetit, për manifestimet që organizohen nga komuniteti pakicë.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi: Propozojë që të shikohet plani i veprimit për komunitete dhe të aplikohet brenda KAB-it.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Sa i përket buxhetit për ZKKK-në janë të ndara 10.000 € tani për tani mendojë se mundësitë buxhetore janë të limituara. Ndërsa sa i përketë stafit siç e dini Muhameti ka shkuar në ZKKK-ë dhe mundësi tjera për vitin e ardhshëm nuk ka. Ky është një draft dhe Kuvendi ka mundësi të bëjë ndryshime.

z.Arton Demiri: Përshëndetje. Sa i përketë pagesave për manifestime, unë nuk kamë asnjë dilemë që drejtori i paguan, sepse mendojë se as në bankë nuk mundesh me i marrë paratë më shpejtë, ashtu qysh ka thënë brenda 3 dite na kanë dalë paratë.

z.Besnik Seferi: Po ndërlihem me drejtorin, ne kemi një përgjegjësi që e bartim. Unë e përkrahu propozimin e kryesuesit që duhet me pasë një vijë buxhetore të DKRS-ja. Ne i kemi fajet sepse ne duhet të marrim vendim. Është shumë e rëndësishme që edhe kjo qështja e organizimit të manifestimeve të bëhet denjësishtë.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi: Unë jam i mendimit që drejtorit me ja lënë mundësinë edhe për një kohë për me i marrë parasyshë të gjitha këto propozime që i dhamë.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Sa e di unë për këto manifestime nuk është ndonjë shumë e madhe më duket se është 2-3 mijë euro, vetëm e bëni një parallogari, dhe unë besoj që kjo kryhet.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi: Unë po dua për me i qitë në votim këto propozimet e mijë. Propozimi imë është që këto me shku për muajin tjetër me qëllim që me i lënë hapësirë drejtorit për me i analizuar.

* Komiteti për Komunitete në mbledhjen e -VI- për vitin 2025, të mbajtur më: 26.06.2025, me 6 vota "Për" me 0 vota "Kundër" dhe me 1 votë "Abstenim" vendosi që të shkojë me votim.

* Komiteti për Komunitete në mbledhjen e -VI- për vitin 2025, të mbajtur më: 26.06.2025, unanimisht vendosi që t'i Rekomandon Kuvendit të Komunës së Shtimes, që të miratoi Draft-Kornizën Afatmesme Buxhetore për periudhën 2026-2028, me propozimet:

1. Të bëhet rritja e buxhetit të Zyrës për Komunitete dhe Kthim, nga 10 në 12 mijë euro,
2. Të analizohet mundësia për pranimin edhe të një zyrtari në ZKKK-ë,
3. Të hapet një vijë buxhetore të DKRS-ja për manifestimet qendore të Komuniteteve,
4. Të bëhet funksionalizimi i qendrave mësimore në fshatrat Gjyrkovc dhe Vojnovc.

Pika 3

Informatë nga ZKKK-ja për mbështetjen e komuniteteve në muajin Qershor 2025

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi: Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja japë Muhamet Mehmetit.

z.Muhamet Mehmeti, zyrtar i ZKKK: Përshëndetje. Pajtohem me drejtorin kur tha se Ferizaji është komunë më e madhe dhe nuk kanë të ndarë vijë buxhetore për ZKKK-në, ndërsa ne në Shtime për këtë zyre i kemi të ndara 10 mijë euro. Sa i përket informatës materialin e keni pranuar me kohë dhe e keni lexuar. Unë do ta lexojë informatën në pikat kryesore. (Shih dokumentin)

Nëse ka dikush ndonjë pyetje unë do të përgjigjem.

znj.Rrezartë Ramadani: Faleminderit për informatën, u tha që ka tentime për braktisjen e shkollave. Çfarë keni bërë ju për ta parandaluar, dhe çfarë cikli i takojnë kjo kategori e nxënësve?

z.Muhamet Mehmeti, zyrtar i ZKKK: Këta nxënës i takojnë klasave të 6 deri 9. Problemet janë kryesisht mungesat e shumta të nxënësve. Nuk ka ndonjë çështje tjetër të rëndësishme që ndikon në braktisjen e shkollës.

z.Besnik Seferi: Te çështja e buxhetit po më intereson se sa buxhet ka mbetur i pa shfrytëzuar. Sa i përket kërkesave ato duhet të bëhen me shkrim.

z.Muhamet Mehmeti, zyrtar i ZKKK: Tani i kemi të pa shfrytëzuara edhe 9.650 €. Buxheti është i pa shfrytëzuar për arsye se kërkesat janë ende të pa shqyrtuara nga komisioni. Po presim që së shpejti komisioni të tubohet dhe të i shqyrtojë kërkesat.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi: Faleminderit Muhamet, për informatën dhe tani po vazhdojmë me pikën e funditë.

Pika 4

Të ndryshme

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi: Para se të hapi diskutimin për këtë pikë desha të i falenderojë dhe të ju urojë mirëseardhje kolegut Artan Lubovci dhe kolegeve znj.Arjeta Maliqi dhe znj.Sabrie Velui, si anëtarë të rinjë të komitetit. Më vjen mirë që tani e kemi të kompletuar komitetin për komunitete. Pasi që diskutime të tjera për këtë pikë nuk ka, unë ju falënderoj për pjesëmarrjen dhe kontributin e juaj dhe mbledhjen e përfundoj në ora 16:24h.

Procesmbajtës
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Komitetit
Bajram Ilazi

